

V E N D I M
Nr. 526, datë 31.10.2002

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 479, DATË 31. 8. 2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRGATITJEN DHE REALIZIMIN E KONTRATËS SË
KONCESIONIT PËR NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË PASAGJERËVE NË
AEROPORTIN E RINASIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në pikën 2 të vendimit nr. 479, datë 31. 8. 2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Procedurat për kriteret e përzgjedhjes së investitorit për fazën e parë (parakualifikimi) përcaktohen sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Organi shtetëror i autorizuar (OSHA) të nxjerrë urdhrin përkatës për fillimin e procedurave të publikimit të shprehjes së interesit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKS

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE STRATEGJIKË TË INTERESUAR
PËR KONTRATËN E KONCESIONIT PËR NDËRTIMIN E TERMINALIT TË RI TË
PASAGJERËVE NË AEROPORTIN E RINASIT**

I. Midis investitorëve që do të kenë dërguar shprehjen e interesit, duke përmbushur kërkesat e treguara në njoftimin publik të publikuar në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.7.1999 “Për procedurat e tenderimit për zgjedhjen e investitorëve strategjikë dhe transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë”, ftesa për tender do t’i dërgohet vetëm kandidatëve që përmbushin kërkesat e parashikuara në pikën II të këtij urdhri, sipas afateve të parashikuara në të.

II. Investitorët strategjikë të interesuar, që do të ftohen të paraqesin ofertat e tyre më të hollësishme të detyrueshme, duhet të përmbushin vetëm kërkesat e mëposhtme paraprase:

II.1. Të jenë shoqëri aksionere ose persona juridikë të ngjashëm sipas legjislacionit të vendit ku ata janë krijuar, të jenë të krijuara dhe të regjistruara tek autoritetet kompetente ku ndodhet selia.

II.1.1. Do të pranohen edhe konsorciume të përbëra nga shoqëri aksionere apo persona juridikë të ngjashëm.

II.1.2. Do të pranohen dhe kombinimet e investitorëve që veprojnë së bashku si konsorcium për qëllimet e këtij koncesioni apo që synojnë të kryejnë transaksionin nëpërmjet një shoqërie që do të krijohet (“Shoqëria e Re”).

II.1.3. Në rastin e kombinimit të investitorëve strategjikë me investitorët financiarë, investitori strategjik duhet të ketë kontrollin e aksioneve.

Angazhimi i subjekteve ndërtuese shqiptare në këto konsorciume do të jetë kusht favorizues për ofertat e investitorëve të interesuar.

Palët të cilat janë në likuidim apo nuk kanë aftësi paguese janë nën administrim apo procedime të tjera të ngjashme, apo ndonjë procedim që nënkupton një mosaftësi paguese apo ndërprerje të biznesit, nuk do të pranohen në procedurën e tenderit.

II.2. Në aktivitetin aeroportual të shoqërisë të përfshihet kapaciteti i Turnover-it vjetor jo më pak se 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milion) euro mesatarisht për tre vitet e fundit, deri me 31 dhjetor 2001.